

TË DREJTAT TUA MBROHEN



TË GJITHË PËR DEMOKRACINË

VIGAN (14), SHPËTIM (14), FATOS (14), DARDAN (14), FATGZON (14), ERËZA (15), NJOMZA (14),
REA (13)



Çka duhet të bëjmë ne për një demokraci sa më të mirë?

Vetë fjala demokraci do të thotë qeverisje e popullit, e me këtë nënkuptojmë që populli i merr vendimet më të rëndësishme për vendin e tij. Demokracia për herë të parë u paraqit në Athinë në vitin 507 p.e.s., por ajo formë e demokracisë nuk ishte demokraci e plotë për shkak se gratë dhe shtesa e varfër nuk e kishin të drejtën e votimit. Por, këtë të drejtë e kishin vetëm burrat e pasur dhe ata që kishin pushtet. Tani mund të themi se kemi të bëjmë me një demokraci të plotë ku secili qytetar që nga moshën 18 vjeçare e ka të drejtën e votës pa dallim gjinie, race dhe feje.

Pra janë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejt-përdrejtë dhe përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese është mënyra e votimit ku qytetarët prej moshës 18 vjeçare i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, kurse demokracia e drejt-përdrejtë aplikohet në shtetet më të vogla, ku merren vendime aty për aty. Kosova si një shtet i pavarur dhe demokratik aplikon demokracinë përfaqësuese.

Demokracia përfshin disa elemente si: shprehja e lirë e mendimit, liria, respekti, barazia, paqja dhe solidariteti. Në të gjitha këto elemente të demokracisë hyjnë të gjitha të drejtat e njeriut si: e drejta për të qenë i lirë, e drejta për shkollim, e drejta për votim, e drejta për punë, etj.

Ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, kemi për detyrë që popullin tonë ta ngrisim në nivel sa më të lartë

me anë të punës, mendimit kritik dhe iniciativave pozitive për vendin. E tërë kjo realizohet përmes pjesëmarrjes aktive në klube e organizata të ndryshme që kontribuojnë në të mirë të shtetit tonë. Prandaj ne si popull duhet të jemi mendje hapur ndaj ngjarjeve aktuale të vendit, në mënyrë që shteti të funksionoj sa më mirë.



Liri dhe paqe për të gjithë



Ne jemi e ardhmja e demokracisë

BASHKIMI BËN FUQINË

IBRAHIM (14), DIELL (14), DENIS (14), VIONA (14), KORAB (14), ERIKA (14), ERMAL (14), DIELLZA (13)

Ne e dijmë që Republika e Kosovës është shtet demokratik dhe ajo i ka institucionet e veta. Ne ju ftojmë që të lexoni artikullin tonë dhe të mësoni më shumë rreth këtyre institucioneve

Republika e Kosovës është shtet demokratik. Si shtet i tillë që është e ka ndarjen e pushtetit.

Pushteti ndahet në Pushtetin Gjyqësor, Legjislativ dhe Ekzekutiv. Kjo ndarje bëhet sepse çdo pushtet i ka detyrat e veta.

Sistemi gjyqësor i Kosovës ndahet në tri gjykata: Gjykata themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata për brenda përbëhet nga gjykatësi, prokurori, avokati, i pandehuri dhe dëshmitarët. Çdo njeri prej tyre ka një rol të rëndësishëm.

Gjykatësi jep mendimin final, prokurori studion rastin e të pandehurit, avokati mbron të pandehurin, kurse i pandehuri është personi që e dyshohet se ka shkelur ligjin.



Gazetarët e këtij artikulli



Ibrahimi dhe Dielli duke punuar Gjykatat



Dielli dhe Ibrahimi duke biseduar për ndarjen e pushtetit



Dielli dhe Ibrahimi duke biseduar për llojet e gjykatave




Peshorja e drejtësisë

KUVENDI


Kuvendi ushtron Pushtetin Legjislativ, ku miratohen ose nuk miratohen ligje të ndryshme. Kuvendi përbëhet nga përfaqësuesit e vendit (deputetët) dhe nga Kryetari i Kuvendit. Në Kuvendin tonë janë 120 deputetë, ku sipas ligjit 30% e deputetëve duhet të jenë gra. Prej 120 deputetëve, 100 deputetë janë qytetarë shumicë, ndërsa 20 vijnë nga komunitetet jo shumicë. Kuvendi ka tri funksione: funksioni përfaqësues, sepse përfaqëson popullin, legjislativ, sepse miraton ligje dhe funksionin kontrollues sepse e kontrollon Qeverinë.



Denisi, Korabi dhe Viona duke punuar Kuvendin



Kuvendi i ilustruar nga Ermali



Ndarja e pushtetit

QEVERIA


Qeveria është një ndër organet më të larta të shtetit i cili, ekzekuton ligjet që miratohen nga Kuvendi dhe për këtë arsye quhet Pushtet Ekzekutiv.

Ajo menaxhon buxhetin e shtetit dhe e shpërndan nëpër ministri të ndryshme. Qeveria përbëhet prej shumë ministrave si: Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, etj.

Çdo ministri e ka udhëheqësin përkatës, dhe ata janë vetë ministrat të cilët udhëheqen nga Kryeministri.



Erika, Diellza dhe Ermali duke punuar për Qeverinë



Ndërtesa e Qeverisë e ilustruar nga Dielli, Denisi & Diellza



Bashkëpunimi në grup

PËRFSHIJU, NËSE JE I PËRJASHTUAR

BUTRINTI (14), BLEONI (14), ELTONI (14), ERIOLA (13), HANA (14), LEARTI (14), NITA (14)
RRONI (14), LORENTINI (14)



Çka duhet të dimë për zgjedhjet?

Zgjedhjet janë baza e demokracisë, ndërsa demokracia jetësohet me zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe të rregullta. Pra, qytetarët e realizojnë të drejtën e tyre të votimit. E drejta e zgjedhjeve përbëhet nga: e drejta për të zgjedhur si dhe e drejta për tu zgjedhur.

Ne kemi të drejtë për të zgjedhur (kryetarin e komunës, asambleistët dhe deputetët), si dhe kemi të drejtë të kandidojmë (mund të kandidojmë për asambleistë, kryetar komune, deputetë). I tërë ky proces ndodh pasi që të arrijmë moshën adekuate, 18 vjeç.

Në Kosovë kemi dy lloje zgjedhjesh: lokale dhe qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhet kryetari i komunës dhe asambleistët ku mandati i tyre është 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Ndërsa, zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët të cilët i voton populli, po ashtu edhe mandati i deputetëve zgjat 4 vjet.

PSE JANË TË RËNDËSISHME ZGJEDHJET?

Në vendet demokratike zgjedhjet janë të rëndësishme, sepse një votë mund të bëjë ndryshimin në udhëheqjen e një vendi. Të votosh do të thotë të bashkëvendosësh, sepse në momentin që voton ti bëhesh pjesë e bashkëqeverisjes.

Ne do t'ju tregojmë disa shembuj që një votë mund të bëjë ndryshim. Për shembull: në vitin 1776, një votë vendosi që gjuha angleze, e jo gjuha gjermane të jetë gjuha zyrtare e Amerikës. Në vitin 1875, një votë vendosi që Franca nga monarkia të bëhet republikë. Në vitin 1911, një votë vendosi që gratë të fitojnë të drejtë vote në Kaliforni, SHBA.

Zgjedhjet janë koha kur të gjithë ty të kushtojnë vëmendjen. Pse? Sepse të gjithë dëshirojnë votën tënde! Shfrytëzo mundësinë, për të zgjedhur më të mirin/mirën!



Një shembull ku na duhet të zgjedhim në përditshmëri



Fotografia e autorëve të artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë